



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 3441 prot.

Shkodër, më 07.11.2022

V E N D I M

Nr. 225, datë 07.11.2022

"Për një ndryshim në Rregulloren e Studimeve në Universitetin e Shkodrës"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1, germa "d"; Statutit të USH-së neni 17, pika 6, germa "r", Rregullores së studimeve në USH, Senati akademik, në mbledhjen e tij të datës 07.11.2022

Vendosi:

1. Të miratojë ndryshimet në nenin 14 të Rregullores së studimeve si më poshtë:

"1. Leksionet si rregull janë me frekuentim fakultativ. Njësitë kryesore mund të përcaktojnë në rregulloret e programeve të studimit frekuentim për lëndë/grup lëndësh të veçanta.

2. Ndjekja e seminareve/ushtrimeve, laboratoreve dhe praktikave profesionale/klinike në programet e studimit me karakter profesional, programet e studimit të ciklit të parë, programet e studimit të ciklit të dytë dhe programet e studimit të ciklit të tretë "Master Ekzekutiv" është 75% e orëve.

Për programet e studimit të ciklit të tretë "Specializime afatgjata" dhe "Doktoratë" ndjekja është 50% seminare/ushtrime, 75% për laboratorë dhe aktivitete profesionale/klinike/kërkimore-shkencore".

2. Ngarkohen Njësitë kryesore për të bërë ndryshimet në rregulloret e programeve të studimeve në përputhje me këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Prof. dr. Suzana GOLEMI

